



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Primeminister Office

AGJENCIONI I VETERINARISË DHE USHQIMIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA VETERINU I HRANU
KOSOVO VETERINARY AND FOOD AGENCY

INFORMATORI PËR IMPORT TË ARTIKUJVE PËR KONTROLL KUFITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Objektivi

Objektivi I Informatorit është informimi I Importuesve për import të artikujve të cilat nënshtrohen kontrollit kufitar veterinar dhe fitosanitar.

Informimi I drejtë ,shpejtë pa pagesë(online) do të jetë stimulim, tërheqje e bizneseve jashtë Kosovës.

Kjo do të ndikojë në përmbushjen e parimeve përmirsimit berjës biznes ne Republën e Kosovës"Trade Logistick"dhe "Investment Climate"lëvizje të lire të mallit.

Synimet dhe Funkcionet e AUV

- Të mos lejohet importimi i prodhimeve ushqimore(shtazore dhe bimore) kafshë dhe bimë dhe joushqimore, dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve dhe bimëve;
- Inspektimit Kufitarë veterinarë dhe fitosanitar në PIK për artikuj ushqimor dhe joushqimor;
- Mbajtja e regjistrit të mirave të eksportuara dhe importuara;
- Kontrollimi i mirëqenies së kafshëve gjatë transportimit të kafshëve të gjalla;

Përkufizimet

"AUV" Agjencioni i Ushqimit dhe i Veterinës

“Autoriteti kompetent” për Republikën e Kosovës është AUV

“OBU”- Operator biznesit ushqimor

„Ushqim ose produkt ushqimor” është secila materie ose produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, i destinuar për konsum të njerëzve ose pritet që njerëzit ta konsumojnë,

“Ushqim” po ashtu nënkupton lëngjet për pije, çamçakëzët dhe çdo substancë e cila qëllimisht shtohet gjatë procesit të prodhimit, përgatitjes dhe përpunimit .

«**ushqim**» përfshinë edhe ujin, si uji që shërben për furnizimin publik të qytetarëve si i pijshëm; uji që përdoret ose e përbën ushqimin me rastin e prodhimit, përgatitjes dhe përpunimit të tij; uji i paketuar në paketim origjinal si uji pijshëm, uji mineral dhe uji i burimit.

«**ushqimin**» nuk përfshinë:

ushqimin për kafshë; kafshët e gjalla, përveç nëse janë përgatitur për plasim në treg për konsum njerëzor; bimët dhe frutat para korrjes, ose para vjeljes; barnat dhe prodhimet mjekësore; kozmetikën; duhanin dhe produktet e tij; materiet narkotike dhe psikotrope sipas Konventës së veçantë të Kombeve të Bashkuara mbi Narkotikët, të vitit 1961, dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Materiet Psikotrope të vitit 1971.

“Artikuj” nënkupton kafshët e gjalla, materialin për mbarështim, artikujt ushqimor me origjinë shtazore, bimore, bimë dhe produktet joushqimore me origjinë shtazore, ushqimin e kafshëve e që janë të përcaktuara në Legjislacionin në fuqi.

“Importim” nënkupton pranimin e artikujve nga një vend tjetër në territorin e Kosovës dhe qarkullimin e lirë të tyre,

“Trajtim” nënkupton largimin e artikujve nga mjetet e transportit apo kontejneri për deponim të përkohshëm, paketimin, ripaketimin apo ç’paketimin (pos riparimit të dëmit të transportit), ndërrimin, heqjen apo vendosjen e vulës së re të tiketave apo mbishkrimeve, duke eliminuar mundësinë e ekspozimit të produkteve çfarëdo trajtimi që mund t’iu shkaktojë ndryshime(dëme).

“Kalimi transit” nënkupton transportimin e artikujve në rrugë tokësore, ajrore dhe ujore me deponim të vulosur prej një vendi në vendin tjetër.

“Ngarkesë” nënkupton një sasi të mallit e cila është e mbuluar nga i njëjti dokument, vjen nga një dërgues, transportohet me të njëjtin mjet transportues, paraqitet në të njëjtën kohë për kontroll veterinar dhe i cili është destinuar për marrësin e njëjtë.

“Produkte” nënkupton produktet ushqimore, joushqimore, materialin mbarështues dhe ushqimin e kafshëve.

“Thundror i regjistruar” nënkupton çfarëdo thundrori të regjistruar përmes dokumentit identifikues të lëshuar nga autoriteti mbarështues apo autoriteti i vendit nga i cili kafshët e kanë origjinën dhe i cili vend administron me regjistrin për atë lloj të kafshës apo çfarëdo shoqate, organizate ndërkombëtare e cila administron me kuajt për konkurrim apo garë.

“Person” nënkupton personin fizik apo juridik.

“Kontrolli i dokumenteve” nënkupton kontrollin e certifikatave veterinare, dokumenteve veterinare apo të dokumenteve të tjera që e shoqërojnë ngarkesën.

“Kontrolli i identitetit” nënkupton verifikimin e përputhshmërisë ndërmjet dokumenteve-certifikatave veterinare dhe dokumenteve të tjera të parapara me rregullat veterinare dhe ngarkesës.

“Kontrolli fizik” nënkupton kontrollin e ngarkesës, mallit në trajta të ekzaminimit si paketimi, temperatura, shija, ngjyra, shëndeti klinik, zgjedhja e mostrave dhe testimi laboratorik.

“Pika e Inspektimit Kufitar- PIK” nënkupton shërbimet në kufi - të miratuara për kryerjen e kontrollit veterinar të importimit e që punojnë nën përgjegjësinë e një veterinarit zyrtarisht të

emëruar - veterinar i PIK, pas të cilit të gjitha ngarkesat për kontrollim veterinar të importit drejtohen nga Dogana.

"Kontrolli veterinar i importit" nënkupton kontrollin e dokumenteve, kontrollin fizik, mostrimin për analiza nga një veterinar zyrtar në PIK.

"Karantinë" nënkupton objektin e veçantë për mbajtje të kafshëve të gjalla për një kohë të caktuar, i cili është i ndarë fizikisht nga objektet tjera në të cilin nuk kanë qasje kafshët tjera.

"Veterinari zyrtar" është veterinarin i emëruar nga Autoriteti kompetent.

"Autoriteti Kompetent" është i Ushqimit dhe i Veterinarisë i Kosovës.

"VPIK " nënkupton veterinarin zyrtar që punon në Pikën e Inspektimit Kufitar.

"Dërguesi" nënkupton çdo person apo subjekt afarist nga i cili dërgohet dërgesa në përputhje me informatat e dhëna në dokumentin e parashtruar.

"Marrësi" nënkupton çdo person apo subjekt afarist tek i cili dërgesa edhe fizikisht arrin në përputhje me informatat e dhëna në dokumentin e parashtruar.

"Importues" nënkupton personin i cili e ka selinë në Kosovë e që e pranon ngarkesën apo e bënë transportimin e saj dhe i cili këtë aktivitet e ka të regjistruar dhe është i licencuar për këtë.

Procedura e importit për artikuj të cilët nënshtrohen kontrollit në kufi.

Sistemi i Harmonizuar i Kodeve i quajtur "TARIK" cakton cilat mallra nënshtrohen kontrollit veterinar dhe fitosanitar kufitar.

Vendimi no 6845 datës 14.12.2015 përcakton listën e mallrave të cilat i nënshtrohen kontrollit veterinar apo fitosanitarë kufitarë

Kontrolli kufitar bazohet në Legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës për kontrollin kufitar të importit, kalimit tranistë eksportit produkteve ushqimore dhe joushqimore , të kafshëve të gjalla dhe të materialit për mbarështimin e kafshëve, bimët, plehurat artificial, ushqim për kafshë.

Qëllimi I Legjislacionit është parandalimi I depërtimit të sëmundjeve zoonotike, kafshëve, bimëve gjatë (import, eksport dhe transit).

Kafshë Shoqërimi

Macet dhe qenët të cilët merren për qëllime jo komerciale të shoqëruar nga personat përgjegjës për ato kafshë, të vaksinuara kundër Tërbimit së paku 30 ditë dhe jo më gjatë se 12 muaj para importimit.

Për kafshë shoqërimi nuk duhet LEJE IMPORTI.

Për kafshë shoqëruese me pronarë të cilat kalojnë tranzit dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Kosovës zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ NR.02/2009 për kushtet e lëvizjes së kafsheve shoqëruese jokomerciale.

Udhëzimi Administrativ 02/2018 përcakton kushtet e regjistrimit dhe identifikimit të kafsheve shoqëruese.

Çka nuk duhet të kontrollohet në kufi

Vlen vetëm për inspektoratin kufitar Veterinar.

Dispozitat Ligjore nuk do të aplikohen për:

1. Produktet ushqimore me peshë deri në 1 kg, që merren në bagazhin personal e që nuk përdoren për qëllime komerciale dhe që e kanë origjinën nga vendet nga të cilat lejohet importi sipas listës përkatëse të lëshuar nga Autoriteti kompetent,
2. Produktet me peshë deri në 1 kg të cilat i janë nënshtruar trajtimit me nxehtë në kontejner hermetikisht të mbyllur në Fo vlerë prej 3.00 apo më shumë të cilat merren në bagazhin personal të udhëtarëve dhe të cilat nuk do të përdoren për qëllime komerciale,

3. Lëkura, leshi, puplat dhe trofetë e gjuetie të thundrorëve dhe shpendëve që i janë nënshtruar trajtimit të plotë të balsamimit që siguron ruajtjen e tyre në temperaturë ambientale si dhe trofe gjuetisë nga llojet tjera, pos shpendëve,

IMPORTIMI:

Ushqimi i cili importohet në Kosovë për plasim në treg, duhet t'i përmbushë dispozitat ligjore për ushqimin,

Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Shëndetësisë, varësisht nga fushë veprimtaria e tyre i përcaktojnë me akt nënligjor kushtet për importimin e ushqimit.

Importi I ngarkesave mund të bëhet vetëm kur Autoriteti Kompetent të ketë lëshuar Certifikaten për kontrollin Veterinar të kafshëve dhe Prodhimeve të tyre.

Ngarkesat duhet të posedoj dokumentacionin e cila shoqëron mallin:

Certifikatën veterinare nga vendi exportues origjinal (kopja duhet të arsyetohet)

Certifikatën e origjinës, B/L ,kopje të faturës dhe dokumente tjera nese kërkohet në raste të dyshimta.

Aplikimi për leje të importit :

Drejtë aplikimi kanë të gjithë OB të regjistruar në Kosovë në MTI.

Aplikuesi për Leje të importit duhet të jetë banorë i Republikës së Kosovës. Në rastin e kompanisë / korporatës me përfaqësi në Republikën e Kosovës , aplikuesi duhet të jetë i autorizuar nga kompania.

Aplikimi:

Aplikacionet për Leje importi mund të mirëtohen në zyrën Qendrore AUV PR apo online përmes web faqes:

ks.net/repository/docs/2016_04_22_134735_Aplikacioni_per_prodhime_ushqimore.pdf.

Dmv.Eroll Shehu, Shef I Inspeksionit Veterinar Kufitar

Tel:+381 38 200 38 338

Procedura dhe dokumentacioni për Leje Importi:

Certifikata veterinare të harmonizuar nga Autoriteti kompetent(jo më e vjetër 60 dite nga data e lëshimit)

Certifikata e origjinës (për mish më origjinë tejoqeanike)

Fatura (kopja)

B/L (kopja e verdhë) për mallra të cilët transportohen me anije.

Aplikimi për leje importi pranohet nga 08:00-12:00 gjatë ditëve të punës .

Tërheqja e lejeve të importit bëhet gjatë ditëve të punës nga 13:30 -15:30.

Lejet e importit nuk kanë kosto financiare.

Të drejtë për aplikim dhe tërheqje kanë persona të autorizuar nga Importuesi.

Kushtet për Leje Importi janë:

1. Shteti exportues të jetë i lire nga sëmundjet e listës A dhe B sipas kodit të OIE-së.
2. Garancionet shtesë lidhur me vaksinimet dhe monitorimet ndaj mbetjeve(rezidua)
3. Fabrikat e përpunimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore të jetë e aprovuar për export në Bashkimin Evropian (të ketë numrin exportues për BE)

Pezullimi I lejeve:

Leja e importit mund të pezullohet në çdo kohë për ndonjë arsye ose nëse personi të cilit I është lëshuar leja nuk I është përmbajtur ndonjërit prej kushteve të përcaktuara në leje ose dispozitave në kuadër të legjislacionit , shpërthimit të ndonjë sëmundje e sanksionuar me Legjislacionin në fuqi dhe OIE –së ,apo incidenti alimentar e cila mund të rrezikoj shëndetin publik, shëndetit e kafsheve dhe bimëve.

Për pezullimin e lejeve nuk behet kompensimi.

Ngarkesat që janë nisur para shpërthimit të sëmundjes nga Lista A dh B sipas OIE-së apo ndonjë incidenti alimentar do të lejohen të hyjnë në Republikën e Kosovës pas dëshmimeve dokumentare dhe verifikimit të tyre.

Dokumentet e nevojshme për Import artikujve për kontroll veterinar dhe fitosanitar kufitar.

Kontroll Veterinar kufitar duhen këto dokumente:

1. Certifikata Veterinare të harmonizuar dhe aprovuar nga Autoriteti kompetent jo më vjetër se 60 ditë.
2. Certifikata e origjinës si dhe kopje të faturës dhe B/L (për mallra transportuar me anije).

Të dhënat gjeografike

Republika e Kosovës gjendet në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe kufizohet me: Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim, Republikën e Maqedonisë në jug, Republikën e Malit të Zi në veri-perëndim, Republikën e Serbisë në veri-lindje. Kufiri i Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror. Pozicioni gjeografik i saj është:

KOORDINATA GJEOGRAFIKE		
Nr	Longitude (Gjatësia)	Latitude (Gjerësia)
Veri	20:48:42.9995	43:16:23.9901
Perëndim	20:00:52.3818	42:43:45.7964
Jug	20:37:17.5130	41:51:07.2305
Lindje	21:47:23.5206	42:39:04.4173

Sipërfaqja e Republikës së Kosovës është 10.908 km², me gjatësi të kufirit shtetëror si më poshtë:

GJATËSIA E KUFIRIT SHTETËROR SIPAS SHTETEVE RRETH KOSOVËS		
SHQIPERI	113.551 k m	
MAQEDONI	170.772 k m	
MALI I ZI	79.165 k m	
SERBI	380.068 k m	
Gjithsej	743.556 km	

Të dhënat Topografike

Pothuaj se të gjithë kufijtë e vendit janë rural dhe malor. Relievi nëpër të cilin kalon kufiri shtetëror i Republikës së Kosovës është në përgjithësi malor. Llojet e relievit ndërron nga malor i thyer, kodrinor, fushor dhe liqenor. Kufiri tokësor duke qene kryesisht malor vështirëson qarkullimin kufitar, sidomos në sezonin e dimrit.

Pikat e kalimit kufitar, numri, llojet, kategorizimi dhe standardizimi

Aktualisht në Kosovë funksionojnë 13 pikë kalime kufitare dhe 2 pikë kalime kufitare të përkohshme Glloboçicë-Borje dhe Orqushë më Shqipërinë, të cilat janë nën mbikëqyrjen e pikë kalimit kufitar të Vërmicë.

Pikat e kalimit kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë janë si në vijim :

- **Vërmica- (Zhdoganim komercial nga 08:00 deri 20:00)**
- **Qafa e Prushit (nuk ka zhdoganim komercial)**
- **Qafa e Morinës (nuk ka zhdoganim komercial)**

Pikë e kalimit kufitar e trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Mali të Zi është:

- **Kulla. (Zhdoganim komercial nga 08:00 deri 20:00 terminali Pejë)**

Pikat e kalimit kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë janë si në vijim :

- **Bërnjak** (Zhdoganim komercial nga 08:00 deri 20:00 terminali Mitrovicë)
- **Jarinje** (nuk ka zhdoganim komercial)
- **Merdare** (Zhdoganim komercial nga 08:00 deri 20:00 terminali Besianë)
- **Mutivodë** (nuk ka zhdoganim komercial)
- **Dheu i Bardhë** (Zhdoganim komercial nga 08:00 deri 20:00)
- **Muçibabë** (nuk ka zhdoganim komercial)

Pikat e kalimit kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë janë si në vijim :


- **Hani i Elezit** (Zhdoganim komercial nga 08:00 deri 20:00)
- **Gllloboqica** (nuk ka zhdoganim komercial)

Pikë e kalimit kufitar të trafikut hekurudhor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë është Hani i Elezit terminali për zhdoganim në Prishtinë,ndërsa me Republikën e Serbisë është Leshaku dhe Merdare (për momentin jashtë funksionit).

Pikë e kalimit kufitar të trafikut ajror është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

PRANIA E AGJENCIVE TE AUTORIZUARA PËR MIK NË PKK				
PKK	POLICIA KUFITAR E	DOGANA E KOSOVËS	AUV	SIPAS SHTETEVE
ANP "Adem Jashari"	I Pranishëm	I Pranishëm	Ekip Mobil	

Vërmica	I Pranishëm	I Pranishëm	I Pranishëm	Shqipëri
Qafa e Prushit	I Pranishëm	I Pranishëm		Shqipëri
Qafa e Morinës	I Pranishëm	I Pranishëm		Shqipëri
Kullë	I Pranishëm	I Pranishëm	I Pranishëm	Malin e Zi
Bërnjak	I Pranishëm	I Pranishëm	I Pranishëm	Serbi
Jarinje	I Pranishëm	I Pranishëm		Serbi
Merdare	I Pranishëm	I Pranishëm	I Pranishëm	Serbi
Mutivodë	I Pranishëm			Serbi
Dheu i Bardhë	I Pranishëm	I Pranishëm	I Pranishëm	Serbi
Muçibabë	I Pranishëm	I Pranishëm		Serbi
Hani i Elezit	I Pranishëm	I Pranishëm	I Pranishëm	Maqedoni
Glloboqica	I Pranishëm	I Pranishëm		Maqedoni
Hani i Elezit (Hekurudhor)	I Pranishëm	I Pranishëm		Maqedoni
Leshaku (Hekurudhor)				Serbi
Merdare (Hekurudhor)				Serbi



Informatë Shtesë:

Inspektorët Kufitarë kanë telefon mobil dhe qasje në internet. Lista e Inspektoreve prezent në PIK dhe numrat e telefonave duhet të jetë në Web Faqe të AUV.

Forma e harmonizuar e certifikatave është në ueb faqe të AUV.

Kjo faqe posedon edhe Listën e Depove Ftohëse të Licencuar dhe kontrolluar nga AUV, tek të cilët duhet të deponohet ushqimi i importuar (me ngrirje të thellë deri -18 C dhe depo 0-5 C)

OBU të cilët nuk kanë Depo të licencuar duhet të dëshmojnë se kanë kontratë me ndonjë depo të licencuar.

Sa i përket eksportit, pajisja e OBU me certifikatë eksporti, OBU duhet të lajmëroj me telefon inspektorin rajonal, ky do të jetë prezent në zyre gjatë fundjavës dhe festave.